



Prishtinë, 15 korrik 2016
Kodi i ZRRE-së: V_835_2016

Bordi i Zyrës së Rregulatorit për Energi

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparografi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparografi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregulatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 6 par. 2.8 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-741-2015 të datës 16 korrik 2015 për shoqërinë N.T.SH.“Eling”, se ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare-fotovoltaikë në vendin e quajtur Kuke ZK Livagjë, me kapacitet të instaluar prej 0.4 MW, në Komunën e Graçanicës, Republika e Kosovës;
- Kërkesën për ndërrim të lokacionit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaikë me kapacitet të instaluar prej 0.4 MW, nga lokacioni në vendin e quajtur Kuke ZK Livagjë, Komuna e Graçanicës në lokacionin ZK Drenoc, Komuna e Deçanit, të datës 31.03.2016 për shoqërisë N.T.SH.“Eling”, me adresë: „Dardania“ SU 1/1 Hyr. 2 Nr. I-b, 10000, Komuna e Prishtinës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 15 korrik 2016 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për ndërrim të lokacionit për shoqërinë N.T.SH.“Eling”, për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare-fotovoltaikë me kapacitet të instaluar prej 0.4 MW, nga lokacioni në vendin e quajtur Kuke ZK Livagjë, Komuna e Graçanicës në lokacionin ZK Drenoc, Komuna e Deçanit, Republika e Kosovës.

A r s y e t i m

- ZRRE me datë 31.03.2016 nga shoqëria N.T.SH. “ELING”, ka pranuar kërkesën për ndërrim të lokacionit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaikë me kapacitet të instaluar prej 0.4 MW, nga lokacioni në vendin e quajtur Kuke ZK Livagjë, Komuna e Graçanicës në lokacionin ZK Drenoc, Komuna e Deçanit.
- ZRRE, me datë 26.01.2015 nga shoqëria N.T.SH. “Eling”, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare-fotovoltaikë në vendin e quajtur Kuke ZK Livagjë, me kapacitet të instaluar prej 0.4 MW, në Komunën e Graçanicës, Republika e Kosovës.
- ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga panelet solare/fotovoltaikë, me datë 16 korrik 2015 ka



lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_741_2015, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

- Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (1) një vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqëria N.T.SH. "Eling", do t'i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- Shoqëria N.T.SH. "Eling", në kërkesën e saj për ndërrim të lokacionit ka sqaruar se: për ndërtimin e gjeneratorit të tillë në bazë të studimeve është konstatuar se kostoja e tokës është shumë e shtrenjtë në pozicionin e ZK Livagj, komuna e Graçanicës, sepse pozicioni i tillë është në qendër të Bizneseve afér QMI-së., sepse kostoja e tokës e mbërrin diku afér krejt investimin e gjeneratorit të tillë, gjë e cila është **e disfavorshme kur kihet parasysh afati kohor i kthimit të investimeve për projektin e tillë**.
- Shoqëria N.T.SH. "Eling", në kërkesën e saj poashtu ka sqaruar se arsyet tjetër me rëndësi është se pjesa ku është menduar të vendoset gjeneratori solar në Livagjë, Komuna e Graçanicës, sipas studimeve, ajo pjesë mban shumicën e kohës mjegull dhe ndikon jashtëzakonisht shumë në efikasitetin e paneleve solare, poashtu ndotja nga Termocentrali Kosova "A", në atë region është shumë prezente, gjë e cila ka ndikim shumë të madh në eficienët e gjeneratorit solar. Ndërsa pozicioni në të cilën mendohet të ndërtohet gjeneratori solar në Komunën e Deçanit i eviton problemet e cekura më lartë. Andaj ka theksuar se kërkesa është e arsyeshme dhe njëkohësisht krijon kushte për zhvillimin me sukses të projekteve.
- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 15 korrik 2016 ka vlerësuar kërkesën e shoqërisë N.T.SH. "Eling", për ndërrimin e lokacionit nga ZK Livagjë, Komuna e Graçanicës në lokacionin ZK Drenoc, Komuna e Deçanit, ka shqyrtauar të gjitha detajet ka analizuar edhe dëshmitë relevante në lidhje me këtë projekt, ka marr parasysh edhe dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi kur ka refuzuar kërkesën e tillë, ngase me vendimin për Lëshimin e Autorizimit Preliminar nr. V_741_2015 të datës 16 korrik 2015 shoqërisë në fjalë i është lejuar për zhvillimin e projekteve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare-fotovoltaikë fotovoltaikë me kapacitet të instaluar prej 0.4 MW, në lokacionin në vendin e quajtur Kuke ZK Livagjë, Komuna e Graçanicës e jo në lokacionin e ZK Drenoc, Komuna e Deçanit.
- Bordi i ZRRE-së, ka theksuar se për investim në lokacionin e caktuar, në mënyrë që të mos ketë investitor të dyfishtë dhe se parimi i Lëshimit të Autorizimit Preliminar është dhënia e mundësisë së investitorëve për përgatitjen me dokumentacion adekuat përderisa lokacioni (e drejta e pronësisë) është siguruar që me rastin e aplikimit.
- Bordi i ZRRE-së, poashtu ka analizuar edhe dispozitat ligjore të nenit 6 paragrafi 2 nënparagrafi 2.8 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit sipas të cilit: " Projektet duhet të




sigurojnë të drejtat pronësore dhe të drejtat të tjera ligjore për ndërtimin në lokacionin përkatës, ashtu siç është propozuar në projektin për ndërtimin e kapaciteteve të reja” dhe në bazë të kësaj aplikuesit i është lëshuar Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar.


- Refuzimi i kërkesës të shoqërisë N.T.SH.“Eling”, për ndërrim të lokacionit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaik me kapacitet të instaluar prej 0.4 MW, nga lokacioni në vendin e quajtur Kuke ZK Livagjë, Komuna e Graçanicës në lokacionin ZK Drenoc , Komuna e Deçanit, është i bazuar në ligj dhe në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.
- II. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfi, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës dhe
- Arkivit të ZRRE-së